

# FORD KUGA



# MËNYRA E THJESHTË PËR TË NGARË NJË FORD KUGA TË RI

**1** EKSPLORONI

**2** ZGJIDHNI

**3** PERSONALIZONI

**4** SPECIFIKIMET

*Kuga ST-Line X FWD FHEV me ngjyrë trupi Blu Metalike (opsion).*



# 1 EKSPLORONI

## MENDONI SËRISH AVENTURËN

Pse ta shihni aventurën si një përvojë të vetme? Për ju, është mënyra si mendoni. Ju e dini që nuk ju duhet një çantë shpine 20 kg dhe një shkëputje gjashtëmujore nga karriera për të ikur në zbulimin e saj. Nga dritat e ndritshme të qytetit te qiejt e gjerë e të gjithanshëm – çdo vend, kohë dhe moment ju sjell diçka të re. Ju prezantojmë me Ford Kuga. Aventurë në çdo udhëtim.

Pamjet përfshijnë aksesoret.

*Kuga ST-Line X PHEV me ngjyrë trupi Platini të Bardhë Metalik (opsion).*



# 1 EKSPLORONI

## FUQI E RRITUR

Me dy versione hibride në dispozicion, fuqia hibride elektrike e Ford Kuga ofron një mënyrë më të pastër dhe ekonomike për të shijuar udhëtimin me SUV. Opsioni Plug-In Hybrid (PHEV) kombinon fuqinë e baterisë me një motor benzine efikas me cikël Atkinson, në mënyrë që të jeni të gatshëm për gjithçka.

Ju mund ta përdorni mjetin vetëm me fuqinë elektrike deri në një distancë prej 62 km\*, e cila është ideale për udhëtimet e përditshme dhe Zonat me Çlirim Ultra të Ulët të Gazrave. Dhe atëherë kur ju nevojitet të dilni jashtë qytetit për udhëtime më të gjata, motori kalon në punë me benzinë.



### Kabulli dhe çanta e kabullit

Karikoni Ford -in tuaj Kuga PHEV kudo që shkoni duke përdorur këtë kabull karikimi portativ të dobishëm në çantën e tij. (Aksesorë)



### Kapak mbrojtës prej motit gjatë karikimit

Moti mund të jetë shumë i paparashikueshëm, prandaj ky aksesori është ndërtuar për të ndihmuar në parandalimin e ngrirjes së kabullit të karikimit në fole gjatë motit të ftohtë. (Aksesorë)

\*Bazuar në karikim të plotë. Diapazoni ekskluzivisht elektrik deri në 62 km duke përdorur Procedurën e Testimit të Automjeteve të Lehta të Harmonizuar në Nivel Botëror (WLTP) vlen për një konfigurim të disponueshëm. Diapazoni konkret ndryshon me kushtet, si p.sh. elementet e jashtme, sjellja në drejtim, mirëmbajtja e automjetit dhe jetëgjatësia e baterisë me jone litiumi.

*"Kuga ST-Line X PHEV" në ngjyrë trupi "Solar Silver" metalike (opsion).*

# 1 EKSPLORONI

## ST-LINE X PAKETA "BLACK"

Jepini Ford Kuga tuaj të ri më shumë karakter. Paketa "Black" e ST-Line X i shton automjetit tuaj një palë disqe alumini 20" me ngjyrë të Zezë Absolute. Dhe për t'ju ndihmuar që të dalloni akoma më tepër kudo që shkoni, ajo përfshin gjithashtu një çati të zezë, pasqyra anësore të zeza, dhe një bisht aerodinamik të madh mbrapa, si dhe një stemë unike të zezë ST-Line, stemë Kuga të zezë mbrapa, mbajtëse frenash të kuqe, plus ka një sërë artikujsh në Koleksionin e Stilit të Ford si aksesorët e paraqitur më poshtë.



Për më tepër informacion vizitoni [ford-accessories.com](https://ford-accessories.com)

*Kuga ST-Line X PHEV me ngjyrë trupi e Bardhë e Akullit metalike (opsion) e paraqitur me disqe 20" në të Zezë Absolute (opsion).*



**1** EKSPLORONI

## ZOTËRONI BOTËN TUAJ

"Ford Kuga" është e përshtatshme si për të eksploruar peizazhet kodrinore, po ashtu edhe për të kërkuar aventura në rrugët e qytetit. Kudo që t'ju çojë udhëtimi, ju do të shijoni ekuilibrin e përsosur midis performancës së qëndrueshmërisë të "SUV" dhe stilit të skalitur bukur.

Gama mbresëlënëse e veçorive ndihmëse të automjetit – duke përfshirë Navigimin "SYNC 3", "FordPass Connect" me "Live Traffic" dhe Kontrollin Përshtatës të Drejtimit me funksionin "Stop & Go"\* – e bëjnë atë ideal për të manovruar në trafikun e rënduar të zonave urbane.

Ose vendosni biçikletën për mal në hapësirën e gjerë të ngarkesës në pjesën e pasme dhe nisuni për në natyrë. Me teknologjitë e avancuara si Drejtimi Inteligent me të Gjitha Rrotat Aktive dhe një Sistem të ri të Modaliteteve të Zgjedhshme të Drejtimit, ju mund ta personalizoni përvojën e drejtimit për t'iu përshtatur kushteve të rrugës.

\*I disponueshëm vetëm për modelet me kambio automatike.

Kuga ST-Line X PHEV me ngjyrë trupi Blu metalike (opsion).



## 1 EKSPLORONI

# RIPËRCAKTONI HAPËSIRËN TUAJ

Ndjesia e lëvizshmërisë dhe lirisë vazhdon brenda automjetit dhe përshkon çdo veçori të brendshme. Nga dizajni fluid i facia-s dhe konsolës qendrore, në stilin e kushtueshëm të sediljeve të përparme Sensico® (standard për Titanium (AGR), Titanium X, ST-Line (AGR) DHE ST-Line X) – Ford Kuga krijon një vend qetësimi me komoditetit premium.

Veçoritë shtesë e inteligjente të dizajnit plotësojnë stilin e jetës aktive. Sediljet e pasme përfshijnë një funksion rrëshqitës, i cili ju lejon t'u ofroni më shumë hapësirë të këmbët e pasagjerëve prapa nëse është e nevojshme, ose të zgjeroni hapësirën e pasme të ngarkesës për më shumë kapacitet për bagazhin. Ndërkohë që dera e pasme që komandohet pa duar ju lejon përdorim hapësirën e ngarkesës edhe kur i keni duart e zëna me çanta (standard).

*Kuga ST-Line X PHEV me Raptin të Zi futet tek përforcuesit Sensico® (standard).*

## BASHKË-PILOTUESI JUAJ INTELIGJENT

Një sërë sistemesh inteligjente në Kuga-n tuaj të re ju ndihmojnë që jeta në rrugë të jetë më e lehtë dhe më e sigurt për të gjithë.

- **Kontrolli i Drejtimit Përshtatës me "Stop & Go"\*2)** mban distancën nga automjeti përpara, dhe mund të ndalojë makinën tuaj pastaj të lëvizë përsëri sipas rrjedhës së trafikut. (Pjesë e një Pakete Opsionesh)
- **Ndihmë Para-Përplasjes<sup>02)</sup> me detektor për këmbësorët dhe çiklistët** monitoron afërsinë tuaj me automjetet e tjera, çiklistët dhe këmbësorët dhe mund t'ju paralajmërojë për një përplasje të mundshme. **Ndihmë për Kryqëzimet** mund të diktojë trafikun që vjen përballë kur përgatiteni të kaloni një kryqëzim dhe të frenojë në rast se automjeti juaj rrezikon të goditet. (Pjesë e një Pakete Opsionesh)
- **Ndihmë për Drejtimin Devijues<sup>02)</sup>** është projektuar për të diktuar devijimet e forta dhe ju ndihmon të manovroni për shmangien e pengesave që ju dalin gjatë rrugës. (Pjesë e Ndihmës Para-Përplasjes)
- **Sistemi Aktiv i Mbajtjes së Korsisë me Ndihmë për Pikën e Verbër<sup>02)</sup>** dikton automjetet në pikën tuaj të verbër dhe ndez një dritë në pasqyrën përkatëse të derës për t'ju sinjalizuar. Në rast se përpiqeni të ndryshoni korsinë ndërsa shfaqet një paralajmërim, sistemi do të ushtrojë një rezistencë të lehtë ndaj timonit për të ndihmuar në uljen e rrezikut të një përplasjeje. (Pjesë e një Pakete Opsionesh)
- **Sinjalizimi për Trafikun Kryqëzues me Frenim Aktiv<sup>02)</sup>** përdor sensorët për të skanuar majtas dhe djathtas kur ecni mbrapsht prej një vend parkimi perpendikular. Sistemi do t'ju sinjalizojë nëse dikton një automjet në lëvizje ose ndonjë rrezik tjetër. (Pjesë e Sistemit të Informacionit për Pikën e Verbër, përfshin Frenimin Aktiv) (Opsion, si pjesë e një pakete)

\*I disponueshëm vetëm për modelet me kambio automatike. Në rast se ndalesa është më e gjatë se tre sekonda, drejtuesi duhet të ndërhyjë dhe të shtypë butonin "RES" ose pedalin e gazit për ta rinisur funksionimin e sistemit.

<sup>0</sup>Përdor sensorë. <sup>2)</sup>Funksion i Ndihmës për Drejtuesin. **Vini re** Funksionet në ndihmë të drejtuesit janë shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen dhe gjykimin dhe nevojën që drejtuesi të kontrollojë automjetin.

*Kuga Vignale PHEV me Lëkurë Windsor të cilësisë së lartë (standard).*





# 1 EKSPLORONI

## PERFORMANCA ELEKTRIKE

Arrini në destinacionet tuaja në mënyrë më efikase me Kuga Plug-In Hybrid. Zgjidhni nëse do përdorni energjinë elektrike apo motorin me benzinë 2.5L me cikël Atkinson të automjetit – ose thjesht lëreni Kuga të zgjedhë për ju. Dhe gjatë çdo udhëtimi, automjeti do të rikuperojë energji sa herë që ngadalësoni ose frenoni.

- **Modaliteti EV Automatik** kalon nga përdorimi i motorit elektrik në motorin hibrid, në varësi të kushteve të drejtimit dhe karikimit të disponueshëm
- **Modaliteti EV Tani** përdor vetëm energji elektrike. Kur bateria është pothuajse e shteruar, ajo kthehet në modalitetin hibrid
- **Modaliteti EV Më Vonë** ju mundëson të kurseni ngarkesën elektrike në bateri për përdorim të mëvonshëm duke e drejtuar automjetin kryesisht në modalitetin hibrid derisa ta ndërtoni
- **Modaliteti i karikimit të baterisë** ju lejon të karikoni baterinë duke përdorur ciklin Atkinson të motorit me benzinë
- **Teknologjia "Geofencing"** e bën edhe më të lehtë drejtimin në Zonat me Emetim të Ulët. Sistemi i navigimit do të shfaqë një zonë të kontrolluar, si p.sh. një Zonë me Emetim të Ulët, për t'ju njoftuar se kur të kaloni në modalitetin EV Tani

*Kuga ST-Line X FWD FHEV me ngjyrë trupi Blu Metalike (opsion).*

## KARIKIMI I THJESHTË

Nuk ka rëndësi nëse jeni në shtëpi apo jashtë, karikimi i Kuga-s tuaj nuk mund të ishte më i lehtë me një prizë të linjës kryesore në shtëpi, një "Ford Connected Wallbox"<sup>2)</sup> ose në pikat publike të karikimit. Përdorni aplikacionin FordPass<sup>†</sup> për të kontrolluar nivelin e baterisë, për të gjetur pikat e karikimit dhe për të marrë njoftime për statusin e karikimit. Automjeti vjen standard me një kabull karikimi për në shtëpi 7.1 m dhe një çantë për kabullin.

- **Një "Ford Connected Wallbox"** ofron komoditetin e karikimit të shpejtë në shtëpi. Është i lehtë për t'u përdorur, mund të instalohet brenda ose jashtë dhe mund të arrijë të karikohet plotësisht në vetëm 3.5 orë\*
- **Karikimi nga rrjeti elektrik** nëpërmjet një prize 230 V në shtëpi mund ta karikojë plotësisht Kuga-n tuaj brenda vetëm 6 orësh\*

<sup>2)</sup>Një "Ford Connected Wallbox" është i disponueshëm si aksesori.

<sup>†</sup>Aplikacioni FordPass, i cili përshtatet me platformat e përzgjedhura të celularëve inteligjent, është i disponueshëm nëpërmjet shkarkimit. Mund të aplikohen tarifatat për mesazhet dhe të dhënat.

\*Kohët për karikim mund të ndryshojnë në varësi të kapacitetit aktual të qarkut elektrik të shtëpisë tuaj.

*Kuga ST-Line X PHEV me ngjyrë të trupit e Bardhë e Ftohtë (opsion).*



## LËRENI KUGA-N TË PARKOHET VETË.

Që nga identifikimi i një hapësire të përshtatshme për parkim deri tek drejtimi i sigurt për të hyrë e për të dalë, "Kuga" e bën parkimin e lehtë, madje edhe në hapësira të ngushta.

- **Ndihmë Aktive në Parkim**<sup>2)</sup> kontrollon timonin ndërsa ju udhëzon për të hyrë dhe për të dalë nga një vendparkimi. Së bashku me kamerën e pasme me pamje të gjerë, sistemi përfshin gjithashtu një kamerë të përparme me pamje të gjerë. (Vetëm me transmision manual. Pjesë e një Pakete Opsionesh)
- **Ndihmë Aktive në Parkim 2**<sup>2)</sup> merr kontrollin e timonit, marsheve dhe pedaleve, ndërsa ju merrni kontrollin e automjetit duke shtypur përsëri butonin e Ndhmës në Parkim gjatë gjithë manovrës. (Vetëm me transmision automatik . Pjesë e një Pakete Opsionesh)
- **Sinjalizim i Trafikut Kryq**<sup>\*2)</sup> ju ndihmon kur lëvizni mbrapsht për të dalë nga vendparkimi, duke ju paralajmëruar nëse po afrohet ndonjë automjet nga të dyja anët. (Përfshin Frenimin Aktiv dhe Mbulimin e Rimorkios) (Pjesë e një Pakete Opsionesh)
- **Kamera me Pamje Mbrapa**<sup>2)</sup> ju siguron një pamje të qartë në të majtë dhe në të djathtë të hapësirës pas makinës kur zgjidhet marshi i lëvizjes prapa (Standard në të gjitha seritë)

\*Pjesë e Sistemit Aktiv të Mbajtjes së Korsisë me Ndhmën për Pikën e Verbër.

<sup>2)</sup>Funksion i Ndhmës për Drejtuesin.

**Vini re** Funksionet e ndihmës për drejtuesin janë funksione shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen, gjykimin dhe nevojën që drejtuesi të kontrollojë automjetin.

"Kuga ST-Line X PHEV" në ngjyrë trupi "Solar Silver" metalike (opsion).





## 1 EKSPLORONI

# SHIKONI DHE TËRHIQNI VËMENDJEN

Ndriçimi i jashtëzakonshëm gjatë natës dhe në shikueshmëri të dobët sigurohet nga fenerët LED të avancuar të Kuga që të tërheqin vëmendjen. Dhe për një udhëtim më të lehtë, më të qetë gjatë natës, Ndriçimi Përshtatës me fenerë LED Dinamikë përdor teknologjinë e kamerave për të ndryshuar konfigurimin e dritës për të ndriçuar kthesat përpara se të hyni në to.

- **Ndriçimi sipas shenjave të qarkullimit** dallon nëse po i afroheni një rrethrotullimi apo një shenje ndalimi dhe i përshtat dritat e fenerëve sipas konfigurimit të rrugës (Pjesë e Paketës së Opsioneve)
- **Ndriçimi për kthesën e pritshme** përdor vijat e korsive për të diktuar kthesat në rrugë dhe i ndriçon kthesat përpara se të hyni në to (Pjesë e Paketës së Opsioneve)
- **Drita të gjata jo-verbuese** përshtat këndin e dritës së gjatë për ndriçim maksimal, ndërkohë që kamera e përparme ndihmon sistemin që të mbrojë drejtuesit e tjerë prej verbimit (Pjesë e Paketës së Opsioneve)



## E BËJMË JETËN MË TË THJESHTË

### FORD SYNC 3

"Ford SYNC 3" integrohet në mënyrë të përsosur me celularin tuaj inteligjent për ta bërë komunikimin dhe navigimin të pamundimshëm\*. Mund të kontrolloni me "AppLink" aplikacionet që përputhen me "SYNC", ndërsa "Apple CarPlay" dhe "Android Auto" ju mundësojnë përdorimin e ekranit me prekje dhe me ngjyra 8" si të ishte celulari juaj inteligjent. Duke përdorur ekranin me prekje apo komanda të thjeshta zanore, mund të bëni telefonata, të shkruani dhe të dëgjoni mesazhe me tekst, si dhe të kontrolloni muzikën dhe navigimin satelitor.

### "FORDPASS CONNECT"

Kuga-t e pajisura me "FordPass Connect"\*\* mundësojnë një gamë të gjerë të funksioneve që janë projektuar për ta bërë udhëtimin më të thjeshtë dhe më të këndshëm. Këto përfshijnë "Live Traffic"†, i cili jep informacion të përditësuar për trafikun në sistemin e navigimit "SYNC 3", dhe "Informacion për Rreziqet Lokale"††, i cili mundet t'ju paralajmërojë për rreziqet që po afrohen përpara se t'i hasni. Në rast aksidenti, "eCall"‡ i ndihmon pasagjerët të telefonojnë shërbimet e emergjencës dhe ndan vendndodhjen tuaj.

**Vini re:** Integrimi i plotë i celularit inteligjent me "SYNC 3" disponohet vetëm me "iPhone 5/Android 5.0 (Lollipop)" e lart. 100% i lidhur. Vetëm "AppLink" mund të jetë me pagesë. Për të verifikuar disponueshmërinë e "Apple CarPlay" dhe "Android Auto" në tregun tuaj, shihni faqet zyrtare të internetit të "Apple CarPlay" dhe "Android Auto" për informacionet më të reja. Përditësimet e hartave ofrohen falas për një kohë të kufizuar pas regjistrimit të automjetit.

\*Mos e drejtoni automjetin kur jeni të shpërqendruar. Përdorni sisteme operimi zanore kur është e mundur; mos përdorni pajisje dore gjatë drejtimit të automjetit. Disa veçori mund të bllokohen kur automjeti është në marsh. Jo të gjitha veçoritë janë të përputhshme me të gjithë telefonat.

\*\*"FordPass Connect" mundëson shërbimet e lidhura dhe është i disponueshëm në automjetet e zgjedhura ose në automjetet me navigim. "FordPass Connect" do të aktivizohet në momentin e dërgimit të automjetit. Mund të zgjidhni nëse doni t'i ndani ose jo disa prej të dhënave. Shërbimi dhe mbulimi i të dhënave nuk disponohet kudo. Mund të zbatohen tarifa për të dhënat. Zbatohen politikat e privatësisë të "FordPass" dhe "Connected Car", të cilat janë të disponueshme në faqen lokale të internetit të "Ford".

†Përdorimi i "Live Traffic" është falas për një periudhë prove fillestare pas regjistrimit të një Ford-i të ri që ka funksionin "SYNC 3" me navigim; më pas nevojitet abonimi për licencën.

††Informacioni për Rreziqet Lokale është pa pagesë për një periudhë prove fillestare pas blerjes së një Ford-i të ri me module të caktuara informacioni për drejtuesin; më pas nevojitet abonimi për licencën.

‡"eCall" e "Ford" ndan vendndodhjen e automjetit dhe ndihmon pasagjerët të telefonojnë, në gjuhën e tyre përkatëse, qendrën lokale të komunikimeve në rast përplasjeje të automjetit që shkakton aktivizimin e një airbag-u ose fikjen e pompës së karburantit. Veçoria funksionon në mbi 40 rajone dhe shtete evropiane.

**Vini re:** Ndezja nga distanca është e disponueshme vetëm për modelet me transmision automatik.



SYNC



1 EKSPLORONI



## APLIKACIONI "FORDPASS"

Që nga funksionet inteligjente në distancë e deri tek raportet e detajuara të gjendjes së automjetit, aplikacioni FordPass<sup>®</sup> ju lejon të përdorni akoma më shumë funksione nëpërmjet telefonit tuaj inteligjent. Për të qenë më të qetë, ju mund ta kyçni apo hapni automjetin tuaj kudo që të jeni, dhe gjatë mëngjeseve të ftohta ju madje mundeni edhe të shkruani akullin në xhamin e përparmë, të aktivizoni ngrohjen e sediljeve dhe timonin me ngrohje (kur është i pajisur) (vetëm për modelet me transmision automatik). (Disponohet vetëm në tregjet e BE-së.)

<sup>®</sup>Aplikacioni "FordPass", i përputhshëm me platformat e caktuara celulari inteligjent është i disponueshëm nëpërmjet shkarkimit. Mund të aplikohen tarifat për mesazhet dhe të dhënat.



SYNC

 FordPass

# 1 EKSPLORONI

## EKRAN I SIPËRM

Shfaq njoftimet e rëndësishme në fushën tuaj të shikimit, në mënyrë që të shikoni rrugën përpara. Në imazhin e qartë dhe të ndritshëm mund të shfaqet përmbajtja e zgjedhur nga ju, duke përfshirë njoftimet për shpejtësinë e automjetit, navigimin, kontrollin e drejtimit dhe të dhënat nga Njohja e Shenjave të Qarkullimit. E pajtueshme me syze dielli të polarizuara.

Mos e drejtoni automjetin kur jeni të shpërqendruar. Shihni manualin e përdoruesit për detaje dhe kufizimet e sistemit.



## MODALITETE TË ZGJEDHSHME DREJTIMI

Modifikojeni përvojën e drejtimit të "Kuga" për t'iu përshtatur kushteve duke përzgjedhur nga modalitetet e disponueshme të drejtimit. Sistemi rregullon cilësimet e ndryshme, duke përfshirë reagimin e pedalit të gazit, ndjesinë e drejtimit si dhe mënyrën e ndërrimit të marsheve të makinat me transmision automatik.



## B&O BEOSONIC™ SISTEMI I ZËRIT

Caktoni gjendjen që ju rrethon për udhëtimet tuaja me Bang & Olufsen Beo Sonic™ Sistem Zëri. Përmirësimi i zërit të artistëve tuaj të preferuar është bërë i thjeshtë me anë të ndërfaqes intuitive me një-prekje. Lëvizni në mënyrë harmonike nëpër katër hapësirat audio: E Ndrohtë, E Ndezur, E Ndroitshme dhe E Relaksuar, për ta përshtatur tingullin me shijen tuaj personale.

Profilet shtesë të paracaktuara mund të përputhen me aktivitetin tuaj për komfort dhe ndjesi të mirë shtesë, si dhe për më tepër emocion.

The Beo Sonic™ është një markë tregtare në pronësi të Bang & Olufsen a/s dhe për të aplikohet, regjistrohet dhe përdoret në jurisdikione të shumta në mbarë botën prej pronarit.

# 1 EKSPLORONI

## DERË E PASME ME KOMANDIM PA DUAR

Hapja ose mbyllja e derës së pasme është e thjeshtë, edhe kur i keni duart të zëna. Ndërkohë që çelësat i keni në xhep ose çantë, thjesht bëni një lëvizje të butë shkelmuese nën qendrën e prapakolpit dhe dera e pasme do të funksionojë pa u dashur të prekni asgjë. Ju gjithashtu mund ta hapni dhe mbyllni atë ndërsa jeni ulur brenda makinës.



## KAMERË PËR SHIKIM PARA DHE PAS<sup>2)</sup>

Kryerja e manovrave të ngushta të parkimit mund të bëhet me profesionalizëm falë pamjeve nga pjesa e përparme dhe e pasme e automjetit që shfaqen në ekranin me prekje. Kamera për shikim pas aktivizohet kur automjeti kalon në marshin e lëvizjes mbrapsht.

<sup>2)</sup>Funksion i Ndhmës për Drejtuesin.

**Vini re** Funksionet në ndihmë të drejtuesit janë shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen dhe gjykimin dhe nevojën që drejtuesi të kontrollojë automjetin.

Kamerat funksionojnë vetëm në shpejtësi nën 10 km/orë.



# 1 EKSPLORONI

## ÇENDEL RIMORKIMI ME PALOSJE

Çengeli plotësisht i palosshëm elektrik i rimorkimit fshihet automatikisht pas prapakolpit kur nuk përdoret, që stili të mos humbasë dhe për përdorim më të lehtë të hapësirës së ngarkesës. Për më shumë kapacitet transportimi dhe magazinimi, çengeli i rimorkimit mund të tërheqë deri në 2,100 kg\* në varësi të motorit (verifikojini me shitësin e "Ford" detajet e mëtejshme).

\*Kapaciteti maksimal i rimorkimit ndryshon në bazë të ngarkesës, konfigurimit të automjetit, aksesorëve dhe numrit të pasagjerëve.




## BESIM DHE KOMFORT

Sediljet elektrike me 12-mënyra me certifikatë AGR (me prerje të pjesshme Sensico®) ju përkëdhelin juve dhe pasagjerin përpara gjatë gjithë rrugëve me kthesa dhe përgjatë autostradave, duke ju ndihmuar që të sigurojnë se ju do të arrini të freskët në destinacionin tuaj. (Opsion) (I disponueshëm për Titanium dhe ST-Line)

### Sedilje ergonomike me certifikim AGR\*\*

Shoqata AGR kryen kërkime për parandalimin e dhimbjeve të shpinës dhe është gjerësisht e mbështetur nga mjekët dhe terapistët.



\*\*Vula e cilësisë AGR (Aktion Gesunder Rücken = Fushata për shpinë më të shëndetshme) Certifikuar dhe rekomanduar nga Forumi i Shoqatës "Shpinë e shëndetshme – Jetesë më e mirë" dhe nga Shoqata Federale e Shkollave Gjermane të Shpinës. Më shumë informacion: AGR e.V., Stader Str. 6, D - 27432 Bremervörde, Telefon + 49 4761/926 358 0.

# 2 ZGJIDHNI

Me mundësi zgjedhjeje për stilin e jashtëm dhe të brendshëm, ekziston një "Ford Kuga" i ri i cili është i duhuri për ju.

## PAMJA E PËRGJITHSHME E GAMËS



### Titanium

Modelet luksoze të "Kuga" ofrojnë nivele të larta sofistikimi dhe komoditeti nga materiale cilësore dhe teknologji shtesë.



### Titanium X

Nivelet e rritura të përsosjes dhe të privatësisë mund të përballohen me anë të teknologjive premium, komfortit ofrohen përmes teknologjisë premium, komfortit të rritur dhe stilit të brendshëm.



### ST-Line

Kuga ST-Line e mrekullueshme ka një karakter të dallueshëm sportiv në falë të stilit të saj të jashtëm unik dhe detajeve të brendshme.



### ST-Line X

I mbushur me atletizëm dhe teknologji të avancuar, Kuga ST-Line X është i përgatitur për çdo rast udhëtimi.



### Vignale

Me karakteristikat e dizajnit unik dhe sipërfaqet ekskluzive prej lëkure të butë në prekje, me "Kuga Vignale" e gjeni veten në një botë luksi bashkëkohor.

## TITANIUM

### Karakteristikat e jashtme standarde

- Disqe aliazhi 17" 5x2-ndarje "Shadow Silver"
- Shina çatie me shkëlqim "Silver"
- Kamera e makinës me pamje të pasme
- Pasqyra elektrike me ngrohje dhe palosje automatike, me sinjale anësore, me ngjyrën e trupit dhe drita për mjegull

### Karakteristikat e brendshme standarde

- Ndriçim i ambientit
- Pasqyrë për shikim pas me errësim automatik
- 2 pika furnizimi USB në pjesën e pasme të konsolës së dyshemesë
- Rregullim manual i këndit të sediljes të drejtuesit dhe pasagjerit në 8 mënyra


### Motorët me karburant/ Motorët

#### Benzinë

- 2.5L Ford Plug-In Hybrid (PHEV) 225 PS (165 kW)
- 2.5L Ford Full Hybrid (FHEV) 190 PS (140 kW)
- 1.5L Ford EcoBoost 150 PS (110 kW)

#### Naftë

- 1.5L Ford EcoBlue 120 PS (88 kW)



# TITANIUM X

### Karakteristikat e jashtme standarde, përveç atyre të "Titanium"

- Fenerë automatikë "LED" pasqyrues me drita "LED" për ditën
- Derë e pasme me komandim pa duar
- Xham i errësuar
- Drita të përparme "LED" kundër mjegullës

### Karakteristikat e brendshme standarde, përveç atyre të "Titanium"

- B&O BeoSonic™ Sistemi i Zërit
- Mbështetëse krahu qendrore me palosje dhe me mbajtëse të integruar për gotë
- Sedilje të pjesshme Sensico® me rregullim elektrik të sediljes së shoferit, në 10 mënyra


### Motorët me karburant/ Motorët

#### Benzinë

- 2.5L Ford Plug-In Hybrid (PHEV) 225 PS (165 kW)
- 2.5L Ford Full Hybrid (FHEV) 190 PS (140 kW)
- 1.5L Ford EcoBoost 150 PS (110 kW)

#### Naftë

- 1.5L Ford EcoBlue 120 PS (88 kW)



### ST-LINE

#### Karakteristikat e jashtme standarde, përveç atyre të "Titanium"

- 18" disqe aliazhi me 5x2 ndarje Rock Metallic
- Grilë e sipërme e përparme me rretë në formë hoje bletësh ngjyrë të Zezë Karboni dhe kornizë e zezë me shkëlqim
- Shina çatie me shkëlqim në ngjyrë "të Zezë"
- Tuba shkarkimi dyshe me lustrim unik të cilësisë së lartë

#### Karakteristikat e brendshme standarde, përveç atyre të "Titanium"

- Pjesë e sipërme e errët
- Tapete dyshemeje prej kadife përpara dhe pas, me tegela të kuq
- Levë marshi me prerje unike të Sensico® me Pjesë Alumini të Mëndafshhtë dhe me qepje të kuqe

#### Motorët me karburant/ Motorët


##### Benzinë

- 2.5L Ford Plug-In Hybrid (PHEV) 225 PS (165 kW)
- 2.5L Ford Full Hybrid (FHEV) 190 PS (140 kW)
- 1.5L Ford EcoBoost 150 PS (110 kW)

##### Naftë

- 1.5L Ford EcoBlue 120 PS (88 kW)

## SERITË



### ST-LINE X

#### Karakteristikat e jashtme standarde, përveç atyre të "ST-Line"

- Fenerë automatik "LED" pasqyrues me dritat e gjata automatike dhe drita "LED" për ditën
- Xham i errësuar
- Derë e pasme me komandim pa duar

#### Karakteristikat e brendshme standarde, përveç atyre të "ST-Line"

- Mbështetëse krahu qendrore me palosje dhe me mbajtëse të integruar për gotë
- Sedilje të pjesshme Sensico® me rregullim elektrik të sediljes së shoferit, në 10 mënyra
- Sistemi Ford "KeyFree" në dyert e përparme, butoni i ndezjes "Ford Power" dhe derë e pasme elektrike me komandim pa duar

#### Motorët me karburant/ Motorët

##### Benzinë

- 2.5L Ford Plug-In Hybrid (PHEV) 225 PS (165 kW)
- 2.5L Ford Full Hybrid (FHEV) 190 PS (140 kW)

##### Naftë

- 1.5L Ford EcoBlue 120 PS (88 kW)



## VIGNALE

### Karakteristikat e jashtme standarde, përveç atyre të "Titanium X"

- Disqe aliazhi 18" me 5x4-ndarje "Luster Nickel"
- Pasqyra elektrike me ngrohje dhe palosje automatike me funksionin e kujtesës
- Paracolpi përpara dhe i pasëm me ngjyrën e trupit dhe detaje të pasme me shkëlqim të lartë


### Karakteristikat e brendshme standarde, përveç atyre të "Titanium X"

- Timon i veshur Sensico®-që të jep ndjesinë e cilësisë së lartë
- Sedilja e drejtuesit me rregullim elektrik në 10 mënyra dhe funksionin e kujtesës
- Fletë të përparme me sipërfaqe alumini me shkrimin Vignale
- Sedilje Sensico®/me lëkure Windsor

### Motorët me karburant/ Motorët

#### Benzinë

- 2.5L Ford Plug-In Hybrid (PHEV) 225 PS (165 kW)
- 2.5L Ford Full Hybrid (FHEV) 190 PS (140 kW)



# 3 PERSONALIZONI

Përshtatni stilin tuaj me një përzgjedhje të ngjyrave, opsioneve të disqeve dhe ekstrave.

Ford Kuga ia detyron pamjen e tij të jashtme të qëndrueshme një procesi të veçantë të lyerjes me shumë faza. Pjesët e trupit prej çeliku të mbushura me dyllë, veshja e sipërme mbrojtëse dhe proceset e aplikimit ndihmojnë për të garantuar se Kuga juaj e re do të ruajë pamjen e saj të mirë për shumë vite në vijim.



**Ngjyra e trupit "Lucid Red" metalike**  
veshje e tejdukshme me nuancë \*

## NGJYRAT



**Ngjyrë solide e trupit "Blazer Blue"†**



**Ngjyrë trupi metalike "Blue Metallic"\***



**Ngjyrë trupi "Solar Silver" metalike\***



**Ngjyrë solide e trupit "Frozen White"†\***



**Ngjyrë trupi metalike "Lucid Red" me nuancë të tejdukshme\***



**Ngjyrë trupi Platin in Bardhë metalik\***



**Ngjyrë e trupit "Agate Black" metalike\***



**Ngjyrë trupi "Magnetic Grey" metalike\***

\*Me çmim shtesë.

†Nuk disponohet në Vignale.

Ford Kuga mbulohet nga Garancia e Ford-it kundër Gërryerjes për 12 vjet nga data e regjistrimit të parë. Në varësi të kushteve të përgjithshme.

**Vini re:** Figurat e makinave të përdorura janë vetëm për të ilustruar ngjyrat e trupit dhe mund të mos pasqyrojnë specifikimet aktuale ose disponueshmërinë e produktit në tregje të caktuara. Ngjyrat dhe dekorimet që tregohen në këtë broshurë mund të ndryshojnë nga ngjyrat aktuale, për shkak të kufizimeve të proceseve të përdorura të printimit.



### 3 PERSONALIZONI

### ZBUKURIMET



**"Ray in Ebony"/"Eton in Ebony"**  
Standarde në Titanium



**"Ray in Ebony"/"Sensico® in Ebony"**  
Standard në Titanium X



**"Foundry in Ebony"/"Eton in Ebony" me qepje të kuqe**  
Standarde për ST-Line

Vini re Sensico® është markë tregtare e "Ford EU" për veshje sintetike të cilësisë së lartë të cilat prodhohen për pjesët e brendshme të automjeteve. Si një tapiceri vegane, ai kombinon një ndjesi të cilësisë së lartë dhe të butë, është e qëndrueshme dhe duket e mrekullueshme. Mirëmbajtja e tij është e thjeshtë, pastrohet lehtë dhe është rezistente ndaj njollave dhe aromave të pakëndshme. Falë pamjes së tij me cilësi të lartë, Sensico® jo vetëm që të jep ndjesi të mirë gjatë një udhëtimi të gjatë, por gjithashtu ofron ndërgjegjësim të mirë sepse nuk është me bazë kafshësh. Është dizajn i sigurt për drejtuesit modernë dhe ambiciozë të makinave.

### 3 PERSONALIZONI

### DISQET



**18"**

**Disqe aliazhi me 5x2-ndarje "Magnetic machined"**  
Opsion për Titanium



**19"**

**Disqe aliazhi me 15-ndarje me shkëlqim të lartë "Ebony Black machined"**  
Opsion për ST-Line dhe ST-Line X



**19"**

**Disqe aliazhi me 10-ndarje "Luster Nickel"**  
Opsion për Vignale



**20"**

**Disqe aliazhi me 10-ndarje "Premium Pearl Grey machined"**  
Opsion për Titanium X, ST-Line X dhe Vignale



**20"**

**Disqe aliazhi me 5x4-ndarje "Absolute Black"**  
Opsion për ST-Line X

Vini re Të gjithë disqet e aliazhit ofrohen si aksesore nëpërmjet Agjentit tuaj Ford me kosto shtesë deri sa të vazhdojnë të jenë në stok. Vizitoni [ford-accessories.com](http://ford-accessories.com)

## 3 PERSONALIZONI

### PAKETA DIMËRORE

- Sedilja e shoferit dhe pasagjerit me ngrohje
- Sediljet e pasme me ngrohje
- Xhami i përparmë me ngrohje "Quickclear"
- Timon me ngrohje



### ST-LINE X PAKETA "BLACK"

- Rrota aliazhi 20" "Absolute Black"
- Çati e Zezë dhe frenues fletë të mëdhaja aerodinamike
- Pasqyra anësore të Zeza
- Rrip i poshtëm ngjyrë e zezë përreth dritave të mjegullës
- Stemë unike e zezë 'ST-Line'
- Stemë unike e zezë mbrapa 'KUGA'
- Nofulla të kuqe të tamburit të frenave
- Veshje pedalesh me aliazh
- Pllakat anësore
- Pjesë e pasme e zezë e derës së pasme
- Mbulesë e zezë e menteshave
- Antenë fletë peshkaqeni e zezë



## 3 PERSONALIZONI

### PAKETA E TEKNOLOGJISË

- Ekran i sipërm
- Katër projektorë LED të plotë (me lakim dinamik, dritat LED të përparme për mjegull, dritat e pasme LED, rregullimi automatik i nivelit të dritave të përparme dhe dritat automatike të gjata jo-verbuese)





### PAKETA E NDIHMËS PËR SHOFERIN

- Ndhmë inteligjente e shpejtësisë
- Kontrolli Përshtatës i Udhëtimit me asistent për bllokimin e trafikut (vetëm për transmisionet automatike) ose Kontrolli Përshtatës i Udhëtimit (vetëm për transmision manual)
- Sistemi i Informacionit për Pikat e Verbra me sistem të paralajmërimit dytësor
- Ndhmues për paralajmërimin e ndryshimit të korsisë
- Sistem i Zbutjes së Përplasjes
- Njohje e shenjave të shpejtësisë
- Asistent për Parkim Automatik
- Kamera me pamje të gjerë para dhe pas
- Mbrojtës për pjesët anësore të dyerve

### 3 PERSONALIZONI

### PJESËT SHITESË



- 1 Mbrojtësja e mbajtjes së ngarkesës\*
- 2 Pllakë e hapësirën së ngarkesës
- 3 Tapet për hapësirën e ngarkesës
- 4 Kamera e kruskotit
- 5 Pllakë mbrojtëse gjatë ngarkimit në parakolpin e pasëm
- 6 Çengel i çmontueshëm rimorkimi

- 7 Shufra të kryqëzuara çatie
- 8 Transportues në çati për biçikletë "Thule®"\*
- 9 Mbrojtëse kundër baltës
- 10 Kabull karikimi për automjeteve elektrike në stacionet e karikimit
- 11 "Ford Connected Wallbox"

- 12 G3+ bazamenti i kutisë së bagazhit me G3+ kutia e bagazhit


\*Artikull mbulohet nga garancia e palët e treta furnizuese, shikoni kapakun e pasmë për detaje.

\*Përmbush kërkesat Evropiane të sigurisë ECE-R17/ISO27955.

Për më shumë aksesore Kuga vizitoni faqen [ford-accessories.com](http://ford-accessories.com)

Për një gamë artikujsh tregtarë të markës "Ford" vizitoni [fordlifestylecollection.com](http://fordlifestylecollection.com)

# 4 SPECIFIKIMET



## MOTOR HIBRID


### KUGA HYBRID (FHEV)

Kombinon një motor benzine dhe një motor elektrik që punojnë së bashku për të përmirësuar performancën dhe efikasitetin e karburantit. Kuga Hybrid gjithashtu mund të udhëtojë në distanca të shkurtra vetëm me energji elektrike me zero emetime.

- Motori 2.5L me cikël Atkinson
- Bateri jon-litium 1,1 kWh 48 volt
- Aftësi për të udhëtuar vetëm në modalitet elektrik
- Karikimi nëpërmjet motorit është i mundur

## Opsionet e duhura të motorit për ju.

Kalimi tek automjeti elektrik nuk ka qenë kurrë më i lehtë. Gjeni zgjidhjen e duhur për stilin e jetës tuaj me një zgjedhje të versioneve Kuga Plug-In Hybrid dhe Kuga Hybrid (hibrid i plotë), së bashku me motorët e avancuar 2.0-litër dhe 1.5-litër EcoBoost me benzinë.




\*\*Emetimi i deklaruar i CO<sub>2</sub> përcaktohet në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të Rregulloreve Evropiane (KË) 715/2007 dhe (BE) 2017/1151 me ndryshimet e fundit. Automjetet e Lehta Tregtare tipi i të cilave është miratuar përmes procedurës së Testimit të Automjeteve të Lehta i Harmonizuar në Nivel Botëror (WLTP) do të përmbajë informacion për konsumin e karburantit/energjisë dhe emetimit të CO<sub>2</sub> për Ciklin e Ri Evropian të Drejtimit (NEDC) dhe WLTP. WLTP do të zëvendësojë plotësisht NEDC-në jo më vonë se deri në fund të vitit 2020. Procedurat standarde të zbatuara të testimit mundësojnë krahasimin ndërmjet llojeve të ndryshme të automjeteve dhe prodhuesve të ndryshëm. Gjatë nxjerrjes nga përdorimi të "NEDC", konsumi i karburantit dhe emetimet e CO<sub>2</sub> të "WLTP" do të lidhen me "NEDC". Do të ketë disa mospërputhje në vlerat e mëparshme të kursimit të karburantit dhe të emetimeve, pasi janë ndryshuar disa elemente të testeve, pra për të njëjtën makinë mund të raportohen vlera të ndryshme të konsumit të karburantit dhe emetimeve të CO<sub>2</sub>.

\*\*\*Llogaritja e diapazonit të mundshëm të udhëtimit në bazë të efikasitetit të karburantit nga 4.9-5.5L/100 km (WLTP) për Kuga EcoBlue Hybrid (mHEV), 5.4-5.7L/100 km (WLTP) për Kuga Hybrid (FHEV) dhe rezervuari i karburantit me kapacitet 54 litra. Për Kuga Plug-In Hybrid diapazoni i mundshëm i udhëtimit me karburant është i bazuar mbi efikasitetin e karburantit nga 5.3-6.1L/100 km (WLTP) në Modalitetin e Mbatjes së Karikimit (kur bateria me tension të lartë është shteruar) dhe kapaciteti i rezervuarit të karburantit 45 litra. Diapazoni i përgjithshëm sipas ciklit të Procedurës së Testimit të Automjeteve të Lehta e Harmonizuar në Nivel Botëror (WLTP) është 3,200 km. Diapazoni aktual ndryshon sipas kushteve, siç janë elementet e jashtëm, mënyrën e drejtimit dhe mirëmbajtjen e automjetit.



Karikim rigjenerues



Karikimi nëpërmjet motorit

**Diapazoni i baterisë**  
nuk disponohet

**Emetimi i CO<sub>2</sub>\*\***  
125-133 g/km

**Diapazoni i karburantit\*\*\***  
944-999 km


**Koha e karikimit**  
nuk disponohet









## KUGA PLUG-IN HYBRID (PHEV)

Kombinon fuqinë elektrike dhe të benzinës për të pasur lehtësisht performancë, ndërkohë që modaliteti vetëm elektrik ju lejon të udhëtoni me zero emetime prej shkarkuesit. Në mënyrë që të ndihmojë në arritjen e distancës maksimale që udhëtoni vetëm në modalitetin elektrik, Kuga PHEV mund të karikohet në shtëpi ose në një stacion publik karikimi.

- Motori 2.5L me cikël Atkinson
- Bateri me jone litiumi 14.4 kWh 48-volt
- Aftësi për të udhëtuar vetëm në modalitet elektrik
- Është i mundur karikimi me prizë



-  Karikim rigjenerues
-  Karikimi nëpërmjet motorit
-  Nevojitet karikimi me prizë
-  Karikimi nga priza e murit 230 V
-  Karikimi nga kutia e instaluar në mur
-  Karikimi nga stacionet publike të karikimit

\*Bazuar në karikim të plotë. Diapazoni ekskluzivisht elektrik deri në 62 km duke përdorur Procedurën e Testimit të Automjeteve të Lehta të Harmonizuar në Nivel Botëror (WLTP) vlen për një konfigurim të disponueshëm. Diapazoni konkret ndryshon me kushtet, si p.sh. elementet e jashtme, sjellja në drejtim, mirëmbajtja e automjetit dhe jetëgjatësia e baterisë me jone litiumi.

\*\*Emetimi i deklaruar i CO<sub>2</sub> përcaktohet në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të Rregulloreve Evropiane (KË) 715/2007 dhe (BE) 2017/1151 me ndryshimet e fundit. Automjetet e Lehta Tregtare tipi i të cilave është miratuar përmes procedurës së Testimit të Automjeteve të Lehta të Harmonizuar në Nivel Botëror (WLTP) do të përmbajë informacion për konsumin e karburantit/energjisë dhe emetimit të CO<sub>2</sub> për Ciklin e Ri Evropian të Drejtimit (NEDC) dhe WLTP. WLTP do të zëvendësojë plotësisht NEDC-në jo më vonë se deri në fund të vitit 2020. Procedurat standarde të zbatuara të testimit mundësojnë krahasimin ndërmjet llojeve të ndryshme të automjeteve dhe prodhuesve të ndryshëm. Gjatë nxjerrjes nga përdorimi të "NEDC", konsumi i karburantit dhe emetimet e CO<sub>2</sub> të "WLTP" do të lidhen me "NEDC". Do të ketë disa mospërputhje në vlerat e mëparshme të kursimit të karburantit dhe të emetimeve, pasi janë ndryshuar disa elemente të testeve, pra për të njëjtën makinë mund të raportohen vlera të ndryshme të konsumit të karburantit dhe emetimeve të CO<sub>2</sub>.

\*\*\*Llogaritja e diapazonit të mundshëm të udhëtimit në bazë të efikasitetit të karburantit nga 4.9-5.5L/100 km (WLTP) për Kuga EcoBlue Hybrid (mHEV), 5.4-5.7L/100 km (WLTP) për Kuga Hybrid (FHEV) dhe rezervuari i karburantit me kapacitet 54 litra. Për Kuga Plug-In Hybrid diapazoni i mundshëm i udhëtimit me karburant është i bazuar mbi efikasitetin e karburantit nga 5.3-6.1L/100 km (WLTP) në Modalitetin e Mbjatjes së Karikimit (kur bateria me tension të lartë është shteruar) dhe kapaciteti i rezervuarit të karburantit 45 litra. Diapazoni i përgjithshëm sipas ciklit të Procedurës së Testimit të Automjeteve të Lehta të Harmonizuar në Nivel Botëror (WLTP) është 3,200 km. Diapazoni aktual ndryshon sipas kushteve, siç janë elementet e jashtëm, mënyrën e drejtimit dhe mirëmbajtjen e automjetit.

\*\*\*\*Kohët për karikim mund të ndryshojnë në varësi të kapacitetit të qarkut elektrik të shtëpisë tuaj.

††Bazuar në baterinë e ngarkuar plotësisht dhe rezervuarin e mbushur plot pa e karikuar/mbushur me karburant. Diapazoni i përgjithshëm sipas ciklit të Procedurës së Testimit të Automjeteve të Lehta të Harmonizuar në Nivel Botëror (WLTP) është 3,200 km.

**Diapazoni i baterisë\***

62 km

**Emetimi i CO<sub>2</sub>\*\***

22-29 g/km

**Diapazoni i karburantit\*\*\***

688-462 km (karburant/elektrik i kombinuar††)

**Koha e Karikimit\*\*\*\***

3.5 orë (Kabull Tip 2) ose 6 orë (kabull standard me 3 kunjë)

	1,5 L Ford EcoBoost 150 PS (110 kW) (me "Auto Start-Stop")	2,5 L Ford me benzinë FHEV hibrid 190 PS (140 kW)	2,5 L Ford me benzinë FHEV hibrid 190 PS (140 kW)	2,5 L Ford Petrol Plug-In Phev Hibrid 225 PS (165 kW)	2,0 L Ford EcoBlue 120 PS (88 kW) (Me Auto Start-Stop)	2,0 L Ford EcoBlue 120 PS (88 kW) (Me Auto Start-Stop)
<b>SUV ME 5 DYER</b>						
Emetimet e CO <sub>2</sub> <sup>90</sup> (g/km) – WLTP i Përgjithshëm	149-152	123-128	130-133	122-126	149-152	156-158
Konsumi i karburantit <sup>90</sup> në L/100 km – WLTP i përgjithshëm	6,6-6,7	5,4-5,6	5,7-5,8	5,4-5,5	5,7-5,8	5,9-6,0
Standardi i emetimeve	Euro 6d Temp	Faza 6d Temp	Faza 6d Temp	Euro 6d Temp	Euro 6d Temp	Euro 6d Temp
Fuqia maksimale PS (kW)	150 (110)	190 (140)	190 (140)	225 (165)	120 (88)	120 (88)
Forca rrotulluese Nm (Nm me mbingarkim)	240	Motor me benzinë 2,5 L: 200 Motor elektrik: 230	Motor me benzinë 2,5 L: 200 Motor elektrik: 230	Motor me benzinë 2,5 L: 200 Motor elektrik: 230	340	340
Lloji i karburantit	Benzinë	Benzinë/elektrike	Benzinë/Elektrike	Benzinë/Elektrike	Naftë	Naftë
Transmisioni	Manual me 6 shpejtësi	(H4F45 (eCVT automatike))	(H4F45 (eCVT automatike))	(H4F45 (eCVT automatike))	Me 8 marshe automatike	Me 8 marshe automatike
Drejtimi	4x2	4x2	4x4	4x2	4x2	4x4
<b>PERFORMANCA<sup>9</sup></b>						
Shpejtësia maksimale (km/orë)	195 (121 mph)	196 (122 mph)	196 (122 mph)	200 (124 mph)	180 (111 mph)	180 (111 mph)
0-100 km/orë (sekonda)	9,7	9,1	9,5	9,2	11,6	11,9
50-100 km/orë* (sekonda)	9,5	—	—	—	—	—
<b>PESHAT DHE NGARKESAT</b>						
Pesha neto (kg) <sup>#</sup>	1564	1701	1773	1844	1667	1735
Pesha bruto e automjetit (kg)	2075	2215	2280	2320	2200	2245
Pesha bruto e mjetit (kg)	3875	3815	3780	3820	4345	4345
Masa maks. e lejuar të tërhiqet (me frena) (kg)	1800	1600	1500	1500	2100	2100
Masa maks. e lejuar të tërhiqet (pa frena) (kg)	750	750	750	750	750	750
Ngarkesa e dobishme	410	410	410	410	410	410

\*Në marshin e katërt. <sup>90</sup>Shifra të testeve të "Ford". Të gjithë motorët me benzinë janë të pajisur me konvertues katalitik.

<sup>#</sup>Paraqet peshën më të lehtë neto duke supozuar një shofer me peshë 75 kg, nivele plot të lëngjeve dhe nivele karburanti 90%, në varësi të tolerancave të prodhimit dhe opsioneve etj. me të cilat është pajisur. Kufijtë e rimorkimit të cituar këtu paraqesin aftësinë maksimale të rimorkimit të automjetit në masën e tij bruto të automjetit për t'u rinisur në pjerrësi 12 për qind mbi nivelin e detit. Performanca dhe kursimi tek të gjitha modelet ulen kur automjetet përdoren për rimorkim. Ngarkesa në një automjet-rimorkio është maksimumi 100 kg në të gjitha modelet. Masa bruto e mjetit me rimorkio përfshin peshën e rimorkios.

<sup>90</sup>Konsumet e deklaruar të karburantit/energjisë sipas WLTP, emetimet e CO<sub>2</sub> dhe diapazonet elektrike përcaktohen në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të rregulloreve evropiane (KE) 715/2007 dhe (BE) 2017/1151 me ndryshimet e fundit. Procedurat standarde të zbatuara të testimit mundësojnë krahasimin ndërmjet llojeve të ndryshme të automjeteve dhe prodhuesve të ndryshëm.

Përveç efikasitetit të karburantit/energjisë të makinës, në përcaktimin e konsumit të karburantit/energjisë së makinës, në emetimet e CO<sub>2</sub> dhe në diapazonin e energjisë luajnë rol mënyra e drejtimit dhe faktorë të tjerë joteknikë. CO<sub>2</sub> është gazi kryesor me efekt serrë përgjegjës për ngrohjen globale. Udhëzuesi për kursimin e karburantit dhe emetimet e CO<sub>2</sub> që përmban të dhëna për të gjitha modelet e reja të automjeteve për pasagjerë disponohet falas në çdo pikë shitjeje.



## 4 SPECIFIKIMET

## DIMENSIONET

	SUV me 5 dyer
Gjerësia e përgjithshme pa çengelín e rimorkimit (mm)	4614-4629
Gjerësia e përgjithshme me pasqyra/me pasqyra të palosura/pa pasqyra (mm)	2178/2000/1883
Lartësia e përgjithshme (pa ngarkesë) (pa shinat në çatí) (mm)	1666-1681
Lartësia e përgjithshme (pa ngarkesë) (me shinat e çatisë) (mm)	1666-1680
Rrethi i kthesës – Cep më cep (m)	11,4-11,5
<b>KAPACITETI I NGARKESËS (LITRA)*</b>	
Varianti me 5 sedilje (i ngarkuar deri tek mbështetësia e sediljes) (me komplet për riparimin e gomave) – Jo PHEV	645**
Varianti me 2 sedilje (ngarkuar në çatí) (me komplet për riparimin e gomave) – Jo PHEV/FHEV	1534
<b>KAPACITETI I SERBATORIT TË KARBURANTIT (LITRA)</b>	
Benzinë dhe FHEV	54
Naftë	54
Automjeti Elektrik Hibrid Plug-In	45

\*Matur në përputhje me ISO 3832. Dimensionet mund të ndryshojnë në varësi të modelit dhe të pajisjeve të montuara.  
 \*\*Gama e ngarkesave me sedilje rrëshqitëse në rreshtin e dytë: 475-645L (jo PHEV/FHEV) dhe 411-581L (FHEV/PHEV).

## DIMENSIONET



Gjatësia: 4,614 mm – 4,629 mm



Gjerësia (me pasqyra): 2,178 mm



Gjerësia (pa pasqyra): 1,883 mm

# 4 SPECIFIKIMET

## NGJYRA DHE ZBUKURIMET

	Ngjyra të njëjta trupi		Ngjyra metalike trupi*				Ngjyra cilësore trupi*	
	Frozen White	Blazer Blu	Agate Black	Blue Metallic	Magnetic Grey	Solar Silver	Lucid Red	White Platinum
<b>TITANIUM</b>								
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljes: “Ray” në “Ebony” Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: Veshja prej Ebony Ngjyra e panelit të instrumentit të sipërm: Ebony Ngjyra e panelit të poshtëm të instrumenteve: Ebony	■	■	■	■	■	■	■	■
AGR Zbukurim dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljes: “Ray” në “Ebony” Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: Sensico® në Ebony Ngjyra e panelit të sipër të instrumenteve: Ebony Ngjyra e panelit të poshtëm të instrumenteve: Ebony	■	■	■	■	■	■	■	■
<b>TITANIUM X</b>								
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljes: Rreze Në Zezak Veshje dhe ngjyra për forcimin e sediljeve: “Sensico®” në “Ebony” Ngjyra e panelit të sipërm të instrumenteve: Ebony Ngjyra e panelit të poshtëm të instrumenteve: Ebony	■	■	■	■	■	■	■	■
<b>ST-LINE</b>								
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljes: “Foundry” në “Ebony” Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: Copë në Ebony me tegel “Generic Red” Ngjyra e panelit të sipërm të instrumenteve: Ebony Ngjyra e panelit të poshtëm të instrumenteve: Ebony	■	■	■	■	■	■	■	■
AGR Zbukurim dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljes: “Rapton” në “Ebony” Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: “Sensico®” në “Ebony” me tegel “Generic Red” Ngjyra e panelit të sipërm të instrumenteve: Ebony Ngjyra e panelit të poshtëm të instrumenteve: Ebony	■	■	■	■	■	■	■	■
<b>ST-LINE X</b>								
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljes: Rapton në Ebony Veshje dhe ngjyra për forcimin e sediljeve: “Sensico®” në “Ebony” me tegel “Generic Red” Ngjyra e panelit të sipërm të instrumenteve: Ebony Ngjyra e panelit të poshtëm të instrumenteve: Ebony	■	■	■	■	■	■	■	■
<b>VIGNALE</b>								
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljes: Lëkurë “Windsor” në “Ebony” Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: Vinyl në Ebony Ngjyra e panelit të sipërm të instrumenteve: Ebony Ngjyra e panelit të poshtëm të instrumenteve: Ebony	—	—	■	■	■	■	■	■

\*Bojërat metalike dhe cilësore janë opsione me çmim shtesë.

■ Në dispozicion — Jo në dispozicion



# REZERVONI SOT NJË PROVË PËR TË DREJTUAR

Mënyra më e mirë për të zbuluar gamën emocionuese të Kuga është duke qenë në timon.

Rezervoni një testim për ju, dhe Shitësi juaj i Ford do të jetë i gatshëm t'ju ndihmojë sa më shpejt që të jetë e mundur.



**Figurat, përshkrimet dhe specifikimet.** Kjo broshurë ka qenë e saktë në kohën e printimit. Megjithatë, politika e Ford-it synon drejt zhvillimit të vazhdueshëm të produktit. E drejta i rezervohet ndryshimit të specifikimeve, ngjyrave dhe çmimeve të modeleve dhe artikujve të ilustruar dhe të përshkruar në çfarëdo kohe në këtë botim. Për të dhënat më të fundit, këshillohuni gjithmonë me shitësin e Ford-it. **Pajisje fakultative.** Kudo në këtë botim, sa herë që një karakteristikë përshkruhet si një "Opsion" ose "Pajisje/Paketë Fakultative", etj., ju duhet të supozoni se ajo do të jetë me çmim shtesë kundrejt modelit bazë, përveçse kur deklarohet ndryshe. Të gjithë modelet dhe kombinimet e ngjyrave varen nga disponueshmëria. **Shënim.** Disa nga figurat janë të një modeli para prodhimit dhe/ose të krijuara me kompjuter, prandaj konstruksioni/funksionet në versionin final të automjetit mund të jenë të tjera në raste të ndryshme. Gjithashtu, disa nga karakteristikat e treguara në automjete mund të jenë fakultative. **Shënim.** Kjo broshurë përmban si aksesore origjinale të Ford-it, ashtu dhe një gamë produktesh nga furnizuesit tanë. Vendosja e aksesoreve shtesë, mund të ketë ndikim në konsumin e karburantit të automjetit tuaj. **Aksesorët e identifikuar janë aksesore markash të zgjedhura me kujdes nga furnizues të palës së tretë, të cilat nuk mbulojnë nga garancia e Ford-it, por nga garancia e vetë furnizuesit të palës së tretë, të dhënat e të cilat mund t'i merrni te shitësi juaj i Ford-it. Marka e fjalës iPod dhe logot janë pronë e Apple Inc. Markat dhe emrat e tjerë tregtarë janë ato të pronarëve të tyre përkatës. **Shënim.** Disa veçori ndihmëse dhe sigurie për drejtuesin e mjetit të përshkruara në këtë broshurë janë projektuar të funksionojnë duke përdorur sensorë, performanca e të cilëve mund të ndikohet nën kushte të caktuara të motit ose të mjedisit.**

Katalogu Botimi Ndërkombëtar është vetëm për informacion të përgjithshëm; specifikimet e bëra nuk kanë lidhje me ndonjë treg të veçantë. Ka mundësi që ilustrimet ose teksti të përmbajnë referenca për modelet, karakteristikat ose kushtet, të cilat nuk janë të disponueshme në disa vende, as si pajisje standarde, as si fakultative. Për më tepër, ato mund të lënë jashtë karakteristika të veçanta që janë të disponueshme. Kështu që, ju lutemi konsultohuni gjithmonë me Shitësin e Ford-it për detajet më të fundit të specifikimeve dhe çmimet aktuale.

Publikuar nga Ford Motor Company Limited, Laindon, Essex, England. Registered në Angli Nr. 235446. © Ford Motor Company Limited.